



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË LEPOSAVIQIT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1	Opinion i Auditimit.....	3
2	Gjetjet dhe rekomandimet.....	7
3	Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit.....	13
4	Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	16
	Shtojca I: Letër konfirmimi.....	19
	Shtojca II: Tabela për komentet e komunës lidhur me raportin e auditimit.....	20
	Shtojca III: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesët e tjera të Raportit të Auditimit.....	21

Për: Z. Zoran Todic, Kryetarit të Komunës së Leposaviqit

Adresa: Leposaviq

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Leposaviqit për vitin përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet¹.

Opinion i kualifikuar për pasqyra financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Leposaviqit, të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Leposaviqit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, komuna nuk i ka të regjistruara pasuritë mbi 1,000€ në SIMKF si dhe nuk e ka vënë në funksion sistemin e-pasuria. Vlera prezantuar në PVF e pasurive të komunës janë nga një regjistër në excel ku nuk përfshinë tërë pasurinë dhe nuk aplikohet zhvlerësimi i pasurive.

Më gjerësisht shih tek nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me

¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik

² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar.

ONISA-P-10 , SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit.

Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Leposaviqit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë

Gjatë angazhimit tonë kemi gjetur se entiteti nuk ka vepruar në pajtueshmëri me autoritetet si:

- Nuk zbaton ligjin nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme përcakton qartë se secila organizatë buxhetore duhet të mbledhë të hyra nga tatimi në pronën e paluajtshme;
- Nuk zbaton ligjin Nr. 04/L-110 për ndërtimet në nenet 16 dhe 27 ka përcaktuar qëllimin e lëshimit të lejeve ndërtimore;
- Nuk zbaton ligjin Ligji nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës; dhe
- Nuk ka nxjerr rregullore të brendshme për taksat, tarifat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike.

Më gjerësisht shih tek nënkapitullin 2,2 Çështjet që ndikojnë në konkluzioni e pajtueshmërisë.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës së Leposaviqit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin

Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës së Leposaviqit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Leposaviqit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Leposaviqit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë, dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, dhe të lëshojmë/hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Leposaviqit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi

³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mospajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Leposaviqit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit tonë, ne kemi vërejtur fusha për përmirësim në regjistrimin e pasurive, keqklasifikimin e shpenzimeve, mos aplikimin e ligjeve për të hyrat, mos protokollim i faturave dhe mos themelimin e NJAB-së, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detaje shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 – Mangësi në menaxhim të pasurive kapitale dhe jo-kapitale

Gjetja Sipas nenit 6 të Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Ky regjistër duhet të përfshijë pasuritë kapitale mbi 1,000€ që duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet në E-pasuri.

Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, komuna ende nuk ka krijuar regjistra të saktë të pasurive mbi 1,000€ si dhe nuk e ka vënë në funksion sistemin e-pasuria. Komuna mban dy regjistra në Excel ku ka regjistruar pasuritë mbi dhe nën 1,000€. Mangësitë e identifikuara janë si në vijim:

- Komuna nuk ka të regjistruara në SIMFK pasuritë andaj është e pamundur të verifikohen vlerat e prezantuara nga komuna. Komuna mban pasuritë mbi 1,000€ në një regjistër në Excel në vlerën 1,912,705€ ndërsa ka shpalosur në PFV vlerën 2,774,116€ të cilat nuk tregojnë vlerën e zhvlerësimit fare. Nëse i mbledhim vetëm shpenzimet kapitale për 3 vitet e fundit, vlera e pasurive të regjistruara do duhej ishte 6,066,995€. Për më tepër nuk ka të regjistruar tokën që është në pronë të komunës.
- Komuna nuk e ka në funksion sistemin e-pasuria, ndërsa regjistrimin e pasurive nën 1,000 € e mban në Excel. Vlera e shpalosur në PFV ishte në vlerën 222,707€, vlerë kjo e cila nuk ka zbritur shpenzimet e zhvlerësimi.

Kjo tregon që vlerat e shpalosur në PFV nuk janë të sakta dhe të plota, kjo për arsye se zyrtari i certifikuar i komunës së Leposaviqit në fund të vitit 2020 nuk kishte qasje në sistem për të qenë në gjendje të regjistrojë pronën.

Ndikimi Dobësitë e identifikuara në menaxhimin e pasurisë që kanë të bëjnë me mos krijimin e regjistrin të pasurive, ndikojnë në raportimin e informatave jo të sakta për pasurinë e komunës dhe vlerën e tyre në PFV të cilat kanë ndikuar në opinion të auditimit. Njëherit, rrit rrezikun e keqpërdorimit dhe keq menaxhimit të tyre.

Rekomandimi B1 Kryetari, duhet të ndërmerr masa për krijimin e regjistrave të pasurive mbi dhe nën 1,000€ duke regjistruar të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B2 – Moszbatimi i ligjeve për mbledhjen e të hyrave (tatimi në pronë, leje ndërtimit, dhe dhënies në shfrytëzim të pronës publike)

Gjetja

Neni 25 i Ligji nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme përcakton qartë se secila organizatë buxhetore duhet të mbledhë të hyra nga tatimi në pronën e paluajtshme. Gjithashtu edhe ligji nr. 04/L-110 për ndërtimet në nenet 16 dhe 27 ka përcaktuar qëllimin e lëshimit të lejeve ndërtimore. Ndërsa Ligji nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës rregullon mënyrën dhe përcakton procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronës.

Gjatë vitit 2020, Komuna nuk kishte mbledhur të hyra nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, dhe pronat e dhëna në shfrytëzim si dhe nuk ka nxjerr rregullore të brendshme për taksat, tarifatat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike. Prandaj edhe niveli i mbledhjes së të hyrave vetjake është shumë i ultë.

Kjo ka ndodhur për shkak se Komuna ende nuk ka vendosur politika të zbatimit të ligjeve dhe nuk ka ndër marrë veprime konkrete për arkëtimin e të hyrave nga këto veprimtari që kanë ndikim të rëndësishëm në nivelin e buxhetit të komunës dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Ndikimi

Mos zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për mbledhjen e tatimeve në pronë, taksave për leje të ndërtimit dhe të taksave e tarifave tjera nga ana e komunës, pasqyron një qasje joserioze për të aplikuar kërkesat ligjore në këtë fushë. Kjo rritë rrezikun e pa pajtueshmërisë me ligjet e aplikueshme dhe redukton nivelin e të hyrave vetjake, si dhe mundësinë e financimit të projekteve nga ky burim i të hyrave.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave , që kanë për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave ligjore si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Njëherit duhet të inicioj pa vonesë hartimin e një rregullore të brendshme për taksat, tarifatat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike.

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2020 ishte 561,492€, prej tyre ishin shpenzuar 554,385€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese tjera, furnizim për zyre, derivate, mirëmbajtje etj. Kemi testuar 46 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 367,065€.

Çështja A1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18, pika 3 e rregullores 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Gjatë testimi të dy pagesave nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 21,940€, kemi vërejtur që natyra e shpenzimit i takonte kategorisë së investimeve kapitale. Këto pagesa ishin kryer për blerjen e pajisjes së zjarrfikësve në vlerë 6,740€ si dhe për laboratorin biokimik në vlerë 15,200€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrollit jo të mirë me rastin e realizimit të pagesave si dhe për shkak të pandemisë.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të Komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-e.

Rekomandimi A1 Kryetari i duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestininim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate

2.3.2 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja A2 – Mos protokollimi i faturave

Gjetja Sipas nenit 24. Pika 1.3 të Rregullës Financiare 01/2013 MF, përcaktohet se fatura duhet të protokollohet/regjistrohet dhe të evidentohet në Librin e Faturave.

Ne kemi vërejtur që Komuna mban libër të protokollit dhe evidenton faturat e pranuar, mirëpo në 46 pagesa për mallra dhe 15 pagesa për investime kapitale kemi gjetur se në fatura nuk vendoset numri i protokollit sipas librit.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kujdesit jo të mirë që me rastin e evidentimit të faturave, të njëjtave nuk i janë vendosur numrat sipas librit të protokollit.

Ndikimi Mos protokollimi i faturave të pranuar paraqet rrezik që faturat të mos paguhen me kohë si dhe data e faturës të krijoj paqartësi më datën e pranimin me rastin e pagesave.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar mbajnë numrin e evidentuar në librin e protokollit.

2.3.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ne kemi identifikuar edhe më tutje që Komuna nuk e kishte themeluar NjAB.

Çështja B3 – Mos themelimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm

Gjetja Ligji Nr. 06 /L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe rregullorja QKR Nr 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, kanë përcaktuar funksionin dhe mënyrën e themelimit të NjAB.

Përkundër rekomandimeve tona të përsëritura, komuna ende nuk ka arritur që të siguroj shërbimet e auditimit të brendshëm dhe nuk janë mbuluar as nga ndonjë organizatë tjetër. Sipas menaxhmentit të komunës, kjo ka ndodhur si rezultat i pamundësisë për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën auditorit të brendshëm për shkak të mos lejimit të zhvillimit të procedurave të rekrutimit nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Ndikimi Mungesa e aktiviteteve të auditimit të brendshëm mund të ndikojë në vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos jetë në gjendje që t'i identifikojë dobësitë e kontrolleve dhe të reagojë me kohë për eliminimin e tyre.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj aprovimin e pozitave dhe të ndërmerr masa lidhur me themelimin dhe funksionimin e NjAB-së, për të siguruar mbështetje në menaxhimin e fushave me rrezik dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit.

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	4,799,738	5,107,908	4,947,369	4,290,990	4,525,469
Grante Qeveritare – Buxheti	4,759,738	4,830,166	4,823,614	4,254,335	4,470,268
Financimi përmes huamarrjes	-	1,890	1,890	-	-
Të bartura nga viti i kaluar ⁵ –	-	95,547	84,755	12,655	44,889
Të hyrat vetanake ⁶	40,000	40,000	29,425	24,000	10,312
Fondi zhvillimor në mirëbesim	-	117,098	-	-	-
Donacionet e jashtme	-	23,208	7,685	-	-

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 308,169€. Kjo rritje është rezultat i rishikimi buxhetor për 27,966€, i bartjes së mjeteve nga Fondi zhvillimor në mirëbesim për 117,098€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar 95,547€ financimit nga huamarrja 1,890€, vendimeve të qeverisë 42,460€ si dhe donacioneve për 23,208€.

Në vitin 2020 Komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit përfundimtar në 2020 ose 4,947,369€, me një përmirësim 8% në krahasim me vitin 2019. Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.

Tabela 2 – Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	4,799,738	5,107,908	4,947,369	4,290,990	4,525,469
Pagat dhe mëditjet	2,354,356	2,216,278	2,210,804	2,010,506	1,495,873
Mallrat dhe Shërbimet	425,228	561,492	554,385	382,402	369,107

⁴ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave


⁵ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁶ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Komunalit	64,000	64,000	64,000	63,969	77,724
Subvencionet dhe Transferet	70,000	338,688	328,113	70,000	69,970
Investimet Kapitale	1,747,726	1,927,450	1,790,067	1,764,133	2,512,795
Rezervat	138,428	-	-	-	-


Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike

Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike në vitin 2020

Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Në raport me buxhetin fillestar, kategoria e Pagave dhe Mëditjeve ishte zvogëluar për vlerën 138,078€. Në fillim ishte rritur me rishikim për vlerën 27,966€, nga huamarrja 1,890€ dhe donacionet 5,474€, mirëpo më vonë me vendim të qeverisë ishte zvogëluar për vlerën 173,409€. Shpenzimet ishin 100€;
- Në raport me buxhetin fillestar, kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për vlerën 136,264€. Kjo rritje ishte nga te hyrat vetanake 34€, donacionet 973€ dhe me vendim të qeverisë për vlerën 135,257€. Shpenzimet ishin 93€;
- Buxheti i Shërbimeve komunale nuk kishte ndryshime buxhetore. Buxheti ishte shpenzuar 100%; dhe
- Buxheti final i subvencioneve ishte rritur në raport me atë fillestar për vlerën 268,688€. Kjo rritje ishte me vendim të qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike nga Covid 19.
- Buxheti final te kategoria e investimeve kapitale në raport me atë fillestar ishte rritur për vlerën 179,724€. Fillimisht ishte rritur buxheti nga fondi zhvillimor në mirëbesim 117,098€ të hyrave vetanake të komunës 95,513€ dhe donacioneve 16,761€. Ndërsa me vonë ishte zvogëluar për 49,648€ me vendim të qeverisë. Shpenzimi në këtë kategori ishte 93%.

Komuna për menaxhimin e pandemisë COVID 19, kishte shpenzuar vlerën 164,937€. Prej tyre nga pagat dhe mëditjet 34,755€, si dhe mallrat dhe shërbimet 130,182€.

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2020 ishin në vlerë 1,664€, ato kanë të bëjnë me taksat administrative dhe nga taksat për certifikata të gjendjes civile.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Të hyrat jo tatimore	40,000	40,000	1,664	1,646	3,924
Totali	40,000	40,000	1,664	1,646	3,924

Sa i përket planifikimit në arkëtimin e të hyrave, komuna ka planifikuar të arkëtoj 40,000€, ndërsa ka arkëtuar vetëm 1,664€ nga taksat administrative. Siç shihet realizimi i planit të të hyrave është shumë i ulët apo 4% me një përqindje të ngjashme me vitin e kaluar.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Leposaviqit ka rezultuar në pesë rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, dy rekomandime janë zbatuar ndërsa tri rekomandime nuk ishin zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjit për tatimin në pronë, atij të ndërtimit, si dhe ligjit për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, që kanë për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave ligjore si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Njëherit duhet të inicioj pa vonesë hartimin e një rregullore të brendshme për taksat, tarifat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike.	Edhe në këtë vit nuk ka ndërmarr masa Komuna për të hyrat si dhe nuk kishte hartuar rregulloren.	Nuk ka filluar zbatimin.

2	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar që punonjësit e komunës paguhen bazuar në kontrata valide. Në të kundërtën, këtë problem ta diskutoj edhe me institucionet përkatëse për të arritur një marrëveshje dhe eliminuar këtë çështje e cila po vazhdon të përsëritet nga viti në vit.	Janë nënshkruar kontratat me afat të pacaktuar.	I zbatuar.
3	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari, duhet të sigurojë që planifikimi i prokurimit të kryhet në përputhje me të gjitha nevojat e kërkuara dhe planifikuara, në mënyrë që të eliminohen kontratat me vlerë minimale dhe të mundësohen blerjet përmes procedurave të hapura.	Në raportin e kontratave të nënshkruara nuk kemi vërejtur që ka blerje më vlera minimale.	I zbatuar.
4	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për krijimin e regjistrave të pasurive mbi dhe nën 1,000€ duke regjistruar të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherit përgatitjes së PFV duhet t'i paraprijë raporti i përgjithshëm i inventarizimit të pasurisë.	Edhe këtë vit kemi mos regjistrim të pasurive, regjistra jo të plotë dhe mos funksionim të e-Pasurisë.	Nuk ka filluar zbatimin.
5	Funksionimi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të siguroj aprovimin e pozitive dhe të ndërmerr masa lidhur me themelimin dhe funksionimin e NjAB-së, për të siguruar mbështetje në menaxhimin e fushave me rrezik dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit.	Edhe këtë vit nuk kshihte themeluar NJAB.	Nuk ka filluar zbatimin.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2020		
1	Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për krijimin e regjistrave të pasurive mbi dhe nën 1,000€ duke regjistruar të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.		
2	Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit	Kryetari i duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.		

3	Çështjet që ndikojnë në opinionin e pajtueshmërisë	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave , që kanë për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave ligjore si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Njëherit duhet të inicioj pa vonesë hartimin e një rregullore të brendshme për taksat, tarifat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike.
4	Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar mbajnë numrin e evidentuar në librin e protokollit.
5	Funksioni i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të siguroj aprovimin e pozitave dhe të ndërmerr masa lidhur me themelimin dhe funksionimin e NjAB-së, për të siguruar mbështetje në menaxhimin e fushave me rrezik dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit.

Nënshkrimet:

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm

Astrit Bllaca, Udhëheqës i Auditimit

Etika Co shpk, (Fatmir Mehmeti person i autorizuar në emër të kompanisë)

Shtojca I: Letër konfirmimi

OPŠTINA LEPOSAVIĆ

POTVRDNO PISMO

O saglasnosti sa nalazima Generalnog Revizora na Izveštaju revizije za 2020 godinu kao i za sprovođenje preporuka

Za: Nacionalnu Kancelariju Revizije:

Poštovani,

Preko ovog pisma, potvrđujem da:

- sam primio nacrt izveštaja Nacionalne Kancelarije Revizije o Reviziji Finansijskih Izveštaja Opštine Leposavić za godinu završno sa 31 decembrom 2020 (u daljem tekstu "Izveštaj");
- delimično se slažem sa nalazima i preporukama i imam komentare u vezi sa sadržajem izveštaja (saglasni smo sa nalazima i preporukama, ali nismo saglasni sa kvalifikovanim mišljenjem), i da ću
- u roku od 30 dana od prijema Završnog izveštaja, dostaviti akcioni plan za sprovođenje preporuka, koji će uključiti vremenske rokove i osoblje koje je odgovorno za njihovo sprovođenje.

g. Zoran Todić

Gradočelnik Opštine Leposavić,

Datum: 05.07.2021. godine,

Shtojca II: Tabela për komentet e komunës lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
<p>Çështja 1: Mangësi në menaxhim të pasurive kapitale dhe jo-kapitale</p>	<p>Ne konsiderojmë se opinioni i kualifikuar nuk duhet të lidhet me këtë gjetje.</p> <p>Lidhur me regjistrimin e pasurive kapitale, përmes SIMFK-së, zyrtarja e Komunës së Leposaviqit nuk kishte qasje në sistem, gjë të cilën e dëshmojmë përmes postës elektronike dërguar zyrtarëve në Thesar, duke filluar nga 04.12.2020. deri më 22.02.2021. Në asnjë ditë të vetme ne nuk morëm qasje në sistem, kështu që ne nuk kemi mundur ta kryejmë regjistrimin. Në anën tjetër, është dorëzuar me një listë të pasurive në një tabelë Excel por që në të njëjtën nuk është llogaritur zhvlerësimi për shkak se llogaritja në mënyrë manuale e amortizimit nuk jep shumat e sakta siç e bën këtë sistemi. Ne konsiderojmë se një llogaritje e tillë nuk është relevante ashtu siç e keni kërkuar.</p>	<p>Përkundër rekomandimeve nga vitet paraprake, Komuna nuk ka regjistruar pasuritë në sistemin SIMFK. Në regjistrin e mbajtur në Excel nuk janë prezantuar të gjitha pasuritë e blera ndër vite. Gjithashtu pasuritë kapitale dhe jo kapitale nuk tregojnë vlerën neto pas zhvlerësimit. Si rezultat pasuria nuk prezanton gjendjen e saktë në PFV.</p>

Shtojca III: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesët e tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸. Ky opinion duhet të veçohet nga opinionin nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërteta, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështje (-t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet - në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose jo i modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo te tillë(a) te mundshëm(me) të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Një keq-deklarim është një ndryshim midis shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një artikulli të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që artikulli të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, ose janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose e agreguar, që nuk është e barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare në tërësi ose keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar të transaksioneve nuk është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit (-eve) material (-e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(-ve).

⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë poashtu edhe deklaratat e ekzekutimit të buxhetit

⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë prova të mjaftueshme të auditimit për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material.

Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Ndryshimet e opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në provat e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit të mjaftueshëm për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria, auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit.

Opinionet e modifikuara mund të jenë:

- Të modifikuara (kualifikuara)
- Të kundërta, ose
- Të mohuara

Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe / ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve është i barabartë ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit që nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit(-eve) material (-e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve e tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret në kontekstin e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive për të përshkruar efektet e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë në pasqyrat financiare ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë,

nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë prova të mjaftueshme adekuate të auditimit. Efektet të përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare
- b) Nëse kufizohen kështu, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Në lidhje me shpalosjet, janë thelbësore për kuptimin e pasqyrave financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe e përhapur.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.